



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 2 pika 2 dhe nenit 15, të ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dispozitave të nenit 12, pika 12.5 dhe nenit 32 të ligjit nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës të Republikës së Kosovës, propozojmë këtë:

D R A F T

S T A T U T

i Galerisë së Arteve të Gjakovës

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

Postal address: Nëna Terezë – Gjakovë, Kosovë / 50000 Tel: +381 390 322 591
kk.rks-gov.net/gjakove/

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 QËLLIMI

1. Statuti ka për qëllim të definoj statusin juridik të Galerisë së Arteve (GAGJ) në Gjakovë, veprimtarinë, organizimin, menaxhimin, financimin, mënyrën e administrimit, mënyrën e shfrytëzimit të hapësirës të saj. Të ofroj ambient të sigurt për punëtorët dhe për shfrytëzuesit e saj.
2. GAGJ është institucion kulturor, i cili ka për qëllim t'i shërbejë zhvillimit të kulturës kryesisht artit pamor, aplikativ dhe figurativ nëpërmjet aktiviteteve artistike të organizuara nga institucione publike, organizatat private, organizatat joqeveritare si dhe të individëve pa dallime.

Neni 2 HIERARKIA JURIDIKE

1. Për realizimin e të drejtave dhe përgjegjësiqve që i takojnë Galerisë së Arteve të Gjakovës zbatohet Ligji për Institucionet e Kulturës në fuqi, këtij Statuti, rregulloret, si dhe aktet tjera nënligjore.

Neni 3 STATUTI JURIDIK

1. Galeria e Arteve Gjakovës ka status të personit juridik, me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë që i takojnë me ligjin mbi Institucionet e Kulturës, këtij Statut dhe akteve tjera nënligjore.
2. Galeria e Arteve e Gjakovës përdor xhirollogari bankare në njërën nga Bankat komerciale të licencuara në Kosovë.

Neni 4
SELIA DHE EMËRTIMI

1. Objekti i GAGJ ndodhet në hapësirën (katin e parë dhe katin e dytë) të Pallatit të Kulturës “Asim Vokshi” – Gjakovë dhe është pronë publike e Komunës së Gjakovës.
2. Galeria e Arteve është në Gjakovë, rruga “UÇK-së” numër 2, objekti - Pallati i Kulturës “Asim Vokshi” në Gjakovë.
3. Emërtimi i plotë është: “Galeria e Arteve të Gjakovës”.
4. Emërtimi i shkurtë është: “GAGJ”.

Neni 5
SHENJAT ZYRTARE

1. Në hyrje të objektit të Galerisë së Arteve të Gjakovës vendoset mbishkrimi në gjuhën zyrtare mbi identifikimin e Galerisë.
2. GAGJ ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore. Kjo e fundit përdoret për protokollimin e shkresave zyrtare;
3. Vula e rrumbullakët është me diametër 4cm, në 3 rrathë koncentrik dhe përmban këto të dhëna:
 - a. Në rrethin e parë, të jashtëm, shkruhet: Republika e Kosovës;
 - b. Në rrethin e dytë shkruhet: Komuna e Gjakovës;
 - c. Në rrethin e tretë shkruhet: Galeria e Arteve në Gjakovë;
 - d. Në mes të vulës është simboli ose logo e galerisë.
4. Teksti i vulës është me shkronja të mëdha të shtypit, në madhësi dhe formë të njëjtë në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Vula katrore e protokollit është e madhësisë 6 x 2. 5cm, me këtë përmbajtje, sipas renditjes:
 - a. Republika e Kosovës;
 - b. Komuna e Gjakovës;
 - c. Galeria e Arteve në Gjakovë;
 - d. Numri i protokollit i njësive organizative, kurse në vazhdim lihet hapësirë për shënimin e numrit të protokollit të shkresës;
 - e. Teksti i vulës protokollare shkruhet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 5
MENAXHIMI DHE SHFRYTËZIMI I GAGJ

1. GAGJ menaxhohet nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DKRS), duke u bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit për Institucionet e Kulturës dhe të organogramit zyrtar komunal.
2. Angazhimi i punonjësve që janë përgjegjës për administrimin dhe për koordinimin e aktiviteteve bëhet nëpërmjet konkursit publik sipas ligjit në fuqi për shërbyesit civil të Republikës së Kosovës.
3. Themelimi i organeve menaxheriale të GAGJ bëhet sipas ligjit në fuqi për institucionet e kulturore.
4. GAGJ shfrytëzohet nga artistë të ndryshëm, nga OJQ-të që e zhvillojnë artin pamor, aplikativ dhe figurativ si dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare që zhvillojnë aktivitete të ngjashme.

Neni 6
MIRËMBAJTJA E OBJEKTIT

1. Për mirëmbajtjen e përgjithshme të objektit kujdeset Komuna e Gjakovës nëpërmjet Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DKRS).

VEPRIMTARIA E GALERISË

Neni 7 FUSHËVEPRIMTARIA E GAGJ

1. GAGJ organizon ekspozita, performanca, instilacione artistike individuale, kolektive, me karakter vendor dhe ndërkombëtar.
2. GAGJ pasuron fondin e galerisë përmes dhuratave dhe blerjeve të punimeve artistike.
3. GAGJ përgatit kuadro për artet pamore, aplikative dhe figurative përmes trajnimeve dhe kurseve të ndryshme.
4. GAGJ organizon takime artistësh përmes programeve të rezidencave artistike në fushën e arkitekturës dhe planifikimit urban, arteve pamore, aplikative e figurative, artit në rrugë, arteve digjitale, letërsisë, dizajnit, kostumografi, koreografi, muzikë klasike dhe bashkëkohore, realitetit virtual, dokumentareve dhe fushave tjera, me karakter inspirues për krijime të reja, studimor, arsimor dhe shkencor për kategorinë profesionale, të rrijë dhe fëmijë.
5. GAGJ merr pjesë në koloni artistike, takime shkencore – kërkimore dhe edukative në vend dhe jashtë vendit.
6. GAGJ bashkëpunon me Galeritë në vend dhe jashtë vendit dhe kontribuon në rritjen e standardeve për demokraci dhe qytetërim.

Neni 8 PLANI I PUNËS DHE RAPORTI VJETOR

1. Për realizimin e këtyre veprimtarive, GAGJ përgatitë projekt propozim dhe angazhon ekspertë.
2. Projektet e GAGJ dhe angazhimet e ekspertëve bëhen në harmoni me ligjin 02/L-57 për institucionet kulturore, respektivisht nenin 34 i ligjit.

Neni 9
BASHKËPUNIMET

1. GAGJ në Gjakovë, bashkëpunon ngushtë me Galerinë e Arteve të Kosovës, Galeritë e qyteteve, Universitetet, Shkollat, Licetë të cilat zhvillojnë dhe kultivojnë lëndën e artit pamor, aplikativ dhe figurativ, me qëllim të ngritjes së kriterit të veprimtarisë së mirëfilltë të veprave artistike.

STRUKTURA E GALERISË, ORGANIZIMI DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 10
EMËRIMI DHE DETYRAT E KOORDINATORIT / KURATORIT TË GAGJ

1. Koordinator/e – Kuratori/e i/e GAGJ zgjedhet dhe emërohet në përputhje me ligjin për shërbyes civil dhe është përfaqësues zyrtar i institucionit.
2. Koordinator/e – Kuratori/e në bashkëpunim me punonjësit tjerë (të angazhuarit), kryen këto detyra:
 - a. Organizon, bashkërendon, mbikëqyrë, bashkëpunon dhe raporton për veprimtarin e GAGJ te Udhëheqësi i DKRS-së dhe te Drejtori i DKRS-së;
 - b. Ushtron edhe detyra të tjera me autorizimin e eprorit, si dhe mbanë përgjegjësi të tjera në përputhje me kontratën e punës, dispozitat ligjore dhe aktet e tjera, të cilat kanë të bëjnë me GAGJ;
 - c. Mbikëqyrë dhe menaxhon programet kulturore, artistike, koncerte, orë letrare, debate, tribuna, promovime, shfaqje të filmave, aktivitete rinore të cilat organizohen në hapësirat e Galerisë;
 - d. Siguron qasje të lirë në informim dhe ofron shërbim të barabartë për të gjithë qytetarët;
 - e. Ndërton dhe menaxhon marrëdhënie reciproke me të gjitha institucionet e tjera kulturore në vend dhe ato ndërkombëtare;
 - f. Bënë Planin e Punës për vitin kalendarik, në bashkëpunim me DKRS-në.

Neni 11
PËRFAQËSIMI

1. Në pamundësi të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi nga Koordinator/e – Kuratori/e i/e, atë mund ta zëvendësoj zyrtarin/en të cilin e cakton drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që në këtë rast ushtron të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e zyrtarit/es.

Neni 12
FINANCIMI I GAGJ

1. Mjetet financiare për kryerjen e veprimtarisë së GAGJ sigurohen nga:
 - a. Buxheti i Komunës së Gjakovës;
 - b. Të hyrat nga anëtarësia dhe kryerja e shërbimeve dhe dhënia në shfrytëzim e hapësirave;
 - c. Të ardhurat nga donacionet, fondacionet, bizneset, OJQ-të e themeluara në Kosovës dhe jashtë saj;
 - d. Burimet e tjera të parapara me ligj dhe aktet tjera nënligjore dhe sipas këtij statuti;
 - e. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Kosovës;
2. GAGJ ka xhirollogarinë e vetë, në njërën prej bankave të licencuara në Kosovës, pas aprovimit të këtij statuti;
3. Hapja e xhirollogarisë bëhet konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës;
4. Mjetet financiare të GAGJ lejohen pas prezantimit të planit të punës dhe projekteve nga menaxheri i GAGJ, pas shqyrtimit nga DKRS, me rekomandim të Drejtorit të DKRS-së dhe pas lëshimit të vendimit nga Kryetari i Komunës së Gjakovës.

Neni 13
NJOFTIMI I PUNONJËSVE DHE TRANSPARENCA

1. Punonjësit e GAGJ obligohen t'i respektojnë dhe t'i zbatojnë rregullat e komunikimit, duke vepruar në respektim të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore të Komunës së Gjakovës.
2. Puna në GAGJ duhet të jetë transparente për publikun dhe duhet të zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore për transparencë.
3. Koordinator/e – Kuratori/e është i autorizuar që të komunikojë me shkrim, duke përdorur mjetet fizike dhe mjetet elektronike (shtypin, radio dhe Tv-të), për çështjet që kanë të bëjnë me punën e galerisë.

Neni 14
TË DREJTAT E PUNONJËSVE

1. Për realizimin e të drejtave të punonjësve të galerisë, kujdesen eprorët e strukturës drejtuese duke vepruar në respektim sipas ligjeve në fuqi.

Neni 15
AKTET NORMATIVE TË GAGJ

1. GAGJ ka të drejtë të nxjerrë rregullore të brendshme, të cilat rregullojnë çështjet organizative, mirëmbajtjes së higjienës dhe rregullit shtëpiakë, të cilat duhet të aprovohen nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
2. Aktet e caktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet të nxirren varësisht prej zhvillimeve në Galerinë e Arteve të Gjakovës.
3. Aktet e miratuara publikohen në tabelën e shpalljeve të institucionit.

Neni 16
SIGURIA E GAGJ

1. Objekti dhe pasuria e GAGJ sigurohen 24 orë, 7 ditë të javës, përmes sigurimit të Pallatit të Kulturës “Asim Vokshi” në Gjakovë.

LËNDA ARKIVORE DHE FUNDUSI – FONDI I GAGJ

Neni 17 LËNDA ARKIVORE

1. Galeria e Arteve e Gjakovës ruan gjithë dokumentacionin në arkiva në pajtim me Ligjin për Arkivat Shtetërore.
2. Nëse Galeria e Arteve e Gjakovës pushon së funksionuari dokumentacioni dhe lënda arkivore, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Arkivat Shtetërore i dorëzohen për ruajtje Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Neni 21 FUNDUSI / FONDI I GAGJ

1. Galeria e Arteve e Gjakovës ka fundusin / fondin e saj dhe obligohet që të ruaj punimet, elementet skenografike, prezantimet e ekspozitave si dhe materialet tjera në hapësirat e Galerisë.
2. Nëse Galeria e Arteve e Gjakovës pushon së funksionuari punimet, elementet skenografike, prezantimet e ekspozitave dhe materialet tjera kalojnë në pronësi të Komunës së Gjakovës.

Neni 17 DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMI

1. Ky Statut ndryshohet dhe plotësohet në të njëjtën mënyrë siç është miratuar nga Asambleja Komunale e Gjakovës.
2. Asambleja Komunale miraton rregulloret dhe aktet tjera nënligjore të Galerisë së Arteve të Gjakovës, të propozuara nga DKRS.
3. Ky statut hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administratës të Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në faqen elektronike zyrtare të Komunës së Gjakovës.
4. Në rast të mospërputhjes së këtij statuti me ligjet në fuqi, përparësi do të kenë dispozitat ligjore të Republikës së Kosovës.